

Gjykata Speciale për gjykimin e krimeve të kryera nga punonjësit e Sigurimit të Shtetit” dhe “Kolegji Special i Ministrisë së Punëve të Brendshme”, përpjekja e regjimit komunist për të institucionalizuar veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit.

Msc. Jonel Hibo

(AIDSSH)

Bio

Jonel Hibo është jurist me formim akademik në fushën e së drejtës penale dhe me përvojë profesionale në administratën publike, sistemin gjyqësor dhe institucionet shtetërore. Që nga tetori i vitit 2023, ai ushtron detyrën pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit. Më parë ka punuar në sekretariate teknike pranë komisioneve të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë Korçë, duke fituar përvojë në administrimin e proceseve institucionale, procedurave ligjore dhe koordinimin administrativ. Ai ka përfunduar studimet universitare në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ku është diplomuar në nivelin Master Shkencor në të Drejtë Penale. Gjithashtu, ka kryer trajnimin profesional pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe mban titullin “Asistent-Avokat” pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë. Formimi i tij profesional përfshin edhe certifikimin si “Specialist në Administrimin Publik” nga Akademia Profesionale Elita, si dhe pjesëmarrjen në një sërë trajnimesh dhe programesh kualifikuese në fusha të ndryshme juridike dhe administrative. Jonel Hibo është gjithashtu i angazhuar në kërkimin dhe publikimin shkencor. Ai është autor i artikullit “**Memoria dhe lustracioni**”, botuar nga Instituti për Studime Politike (ISP). Ndër studimet e tij kërkimore spikat edhe artikulli “**Mënyra se si u trajtuan shqiptarët që punuan në Kosovë gjatë viteve 1940–1944 nga regjimi komunist**”, i botuar në edicionin e gjashtë të revistës “**Dritëhije**”. Interesat e tij profesionale përfshijnë të drejtën penale, administrimin publik, drejtësinë tranzicionale, studimin e regjimeve totalitare dhe ruajtjen e kujtesës historike.

Abstrakt

Ky studim ka për qëllim të analizojë bazën ligjore dhe mekanizmin si funksiononin këto organe të ngritura nga Dekret-Ligjet e Kuvendit Popullor dhe që kishin për qëllim gjykimin e krimeve të kryera prej punonjësve sekretë të Sigurimit të Shtetit (bashkëpunëtorëve) dhe oficerëve të Sigurimit, krijimin, kompetencat dhe përbërjen e “*Gjykatës Speciale për gjykimin e krimeve të kryera nga punonjësit e Sigurimit të Shtetit*”, dhe “*Kolegjit Special të Ministrisë së Punëve të Brendshme*” me veprimtari nga viti 1949-1956 , të miratuara nga anëtarët e Kuvendit Popullor.

Pas vitit 1948, në fillim organet e Sigurimit të Shtetit dhe më pas MPB-ja, e bazuan punën e tyre te një platformë e fshehtë politike dhe organizative të miratuar nga Byroja Politike e Partisë së Punës së Shqipërisë. Në thelbin e tyre këto platforma kanë përcaktuar parimet e punës e të drejtimit të organeve të punëve të brendshme, me karakter agjenturial-operativ, pra mbi ngritjen e rrjetit sekret kategoritë ndaj të cilave ushtrohej apo përjashtohej ndjekja, raporti, që kishin komunistët me këto organe, etj. Platformat asnjëherë nuk u bënë dokumente shtetërore, ç’ ka nënkuptonte se kjo ishte një veprimtari e papabuar në ligj.

“Gjykata Speciale për gjykimin e krimeve të kryera nga punonjësit e Sigurimit të Shtetit” dhe “Kolegji Special i Ministrisë së Punëve të Brendshme”, mbeten rastet e vetme që është legjitimuar veprimtaria represive e ish-Sigurimit të Shtetit. Prandaj nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit arkivor, do të analizohen, politikat represive që ish-Sigurimi përdori ndaj bashkëpunëtorëve të tij.

Për të nxjerrë në pah këto fenomene, do të përdoret një metodologji e integruar, që përfshin shqyrtimin e disa burimeve arkivore si; dekret-ligje të Kuvendit Popullor, vendime të Këshillit të Ministrave, etj. Përmes kësaj metode hulumtuese synohet të evidentohet legjitimiteti i veprimtarisë së këtij institucioni, baza ligjore mbi të cilën funksiononte, etj.

Kjo analizë synon të ofrojë një panoramë tërësore të procesit gjykimor, marrjen e vendimeve prej kësaj gjykate, organet e përfshira në veprimtarinë e kësaj gjykate etj.

Fjalë kyçe: *Platforma, rrjet sekret, material shtrëngues, rezident, agjent informator, strehues.*